



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -129

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-149 PËR
EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-149
PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE**

Neni 1

Neni 12 i Ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 12

Vendosja e personave të dënuar në institucionet korrektuese

1. Personat e dënuar vendosen në institucionet korrektuese në pajtim me vlerësimin e rrezikut, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e dënimit të shqiptuar, moshën, gjininë, gjendjen shëndetësore dhe veçoritë tjera karakteristike të të dënuarve. Nëse është e mundur, të dënuarit vendosen në institucionin korrektues, i cili është afër vendbanimit të përhershëm të tij/saj.
2. Në institucionet korrektuese personat e dënuar vendosen në qeli ose dhoma.

Neni 2

Neni 31 i ligjit, pas paragrafit 2 shtohet një paragraf i ri 2a, me tekstin si në vijim:

2a. Personave të dënuar me rastin e pranimit të tyre në institucion korrektues u lejohen gjësendet e caktuara në qelitë e tyre. Çdo gjësend i cili nuk lejohet në qelitë e tyre ose do të ruhet në depo të sigurta nga Shërbimi Korrektues deri në lirimin e personit të dënuar, ose mund t'i jepet një personi të tretë me kërkesën e të dënuarit.

Neni 3

Neni 36 i Ligjit, paragrafi 2 riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.

Neni 4

Neni 43 i Ligjit riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 43 Përkujdesja shëndetësore

1. Personi i dënuar do të gëzoj të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor të cilat janë në dispozicion në komunitet.
2. Personi i dënuar do të ketë qasje në shërbimet e nevojshme shëndetësore pa pagesë.
3. Përkujdesja shëndetësore në institucion korrektues është në pajtim me rregullat e përgjithshme për përkujdesje shëndetësore, për sigurim shëndetësor dhe për shërbime mjekësore dhe farmaceutike, përveç nëse me këtë ligj parashihet ndryshe.
4. Institucioni përkatës shëndetësor pranë Ministrisë së Shëndetësisë (me tej: institucioni shëndetësor), siguron kushte për shërbime elementare mjekësore.
5. Institucioni shëndetësor, siguron shërbimin mjekësor, shërbimin e përkujdesjes dhe atë të farmacisë për plotësimin e nevojave të kujdesit shëndetësor për personat e dënuar.
6. Personi i dënuar të cilit nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues dërgohet në spitalin e institucionit korrektues, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër për përkujdesje shëndetësore.

Neni 5

Pas nenit 43 të Ligjit, shtohet neni 43/A me tekstin si në vijim:

Neni 43/A

Lirim i mbikëqyrur për përkujdesje mjekësore

1. Të gjitha institucionet korrektuese duhet të sigurojnë qasje të shpejtë në ndihmë mjekësore në raste emergjente.
2. Personat e dënuar që kanë nevojë për trajtim të specializuar ose operim do të transferohen në institucione të specializuara ose në spitale civile.
3. Institucionet korrektuese shqyrtojnë planet e kujdesit mjekësor që plotësojnë kriteret e duhura të cilat u lejojnë personave të dënuar lirim të mbikëqyrur për të pasur qasje në shërbimet e nevojshme shëndetësore në institucionet shëndetësore publike në shoqëri.
4. Personi i dënuar konsiderohet të jetë në lirim të mbikëqyrur, kur pjesëtari i personelit të institucionit korrektues përgjegjës për sigurinë e shoqëron, monitoron dhe siguron me ruajtjen e të personit të dënuar.
5. Masat do të merren për të trajtuar kërkesat legjitime të sigurisë me parimin e konfidencialitetit mjekësor.
6. Staf i mjekësor merr vendimin përfundimtar për përdorimin e prangave ose pajisje të tjera shtrënguese gjatë ekzaminimit mjekësor.
7. Kontrollimi mjekësor dhe dhoma e ekzaminimit mjekësor duhet të jetë e sigurt, mundësisht e pajisur në mënyrë të tillë që të kufizoj rrezikun e arratisjes
8. Koha e kaluar për trajtim mjekësor jashtë institucionit korrektues llogaritet në dënimin me burgim, ose me burgim të përjetshëm.

Neni 6

Neni 48 i Ligjit, titulli i nenit riformulohet me tekstin si në vijim: **“Pëlqimi për përkujdesje mjekësore”**.

Neni 7

Neni 50 i Ligjit, paragrafi 3, pas fjalës “i mundshëm”, shtohen fjalët “sipas standardeve në komunitet”.

Neni 8

Neni 66 i Ligjit, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 66 Pranimi i pakove

1. Personi i dënuar ka të drejtë të pranojë pako.
2. Pakot kontrollohen në prani të personit të dënuar para se t'i jepen atij.
3. Përgjashtimisht nga paragrafi 1 pakot që pranohen nga jashtë nuk lejohet që të përmbajnë ushqim, pije dhe cigare. Përbajtja dhe përmbajtja e lejueshme e pakove rregullohet me aktin për rendin shtëpiak.

Neni 9

Në nenin 70 të Ligjit, pas paragrafit 3 shtohen tetë (8) paragraf të ri, me tekstin si në vijim:

4. Nëse është e mundur, shërbimi korrektues duhet të sigurojë se të dënuarit mundësohet të punojë, duke marrë parasysh aftësitë dhe shkathtësitë fizike dhe mendore të dënuarit. Nëse është e pamundur t'i sigurohet të dënuari puna, i dënuari duhet të merr pjesë në mirëmbajtjen e institucionit korrektues, nëse është e mundshme.
5. Me qëllim që të dënuarve t'ju sigurohet punë, shërbimi i institucionit korrektues mund të ndërtojë impiante brenda ose jashtë territorit të tij, t'i mundojë të dënuarve të punojnë jashtë institucionit korrektues, ose t'ju kërkojnë atyre të marrin pjesë në mirëmbajtjen e institucionit korrektues.
6. I dënuari mund të pezullohet nga puna, ose të lirohet nga puna e detyrueshme nëse i dënuari nuk është në gjendje të kryejë punën e detyrueshme, ose nëse puna e rrezikon sigurinë e të dënuarit, ose institucionit korrektues, ose nëse puna paraqet kërcënim për disiplinën në institucion korrektues. Ministri i Drejtësisë me akt nënligjor përcakton procedurën për punësimin e të dënuarve, pezullimin dhe lirin e të dënuarve nga puna
7. Në mënyrë që të dënuarve t'iu mundësohet të punojnë, mund të jepet edhe leja për ndërtimin e impianteve brenda territorit të institucionit korrektues personave fizik, ose kompanive, nëse këta persona, ose kompani lidhin kontratë përkatëse me shtetin, ose me një person juridik për marrëdhënie detyrimore, kryen detyra administrative të shtetit. Ministri i Drejtësisë përcakton kërkesat për këto kontrata.
8. Kushtet e punës së të dënuarve duhet të jenë në pajtim me kriteret e përcaktuara nga ligji për mbrojtjen e punës. Shërbimit korrektues i kërkohet të sigurojë se të dënuarve ju garantohen kushte të punës, të cilat janë të sigurta për jetën dhe shëndetin.
9. Të dënuarve mund t'ju kërkohet të punojnë jashtë orarit të punës, gjatë ditëve të tyre të pushimit dhe gjatë festave zyrtare vetëm nëse bëhen me pajtim të dënuarve.

10. Të dënuarve që marrin pjesë në mirëmbajtjen e institucionit korrektues ju kërkohet të punojnë në pajtim me natyrën e punës, që vendoset nga shërbimi korrektues.

11. Me urdhër të zyrtarit të shërbimit të institucionit korrektues, të dënuarve ju kërkohet të marrin pjesë në parandalimin e katastrofave natyrore, epidemive, aksidenteve ose katastrofave, ose heqjen e pasojave të tyre si dhe në raste të emergjencave tjera. Në këtë rast, institucioni korrektues duhet të sigurojë sigurimin dhe sigurinë e të dënuarit.

Neni 10

Në nenin 72 të Ligjit, pas paragrafit 2 shtohen tre (3) paragraf të ri, me tekstin si në vijim:

3. Kushtet dhe procedurat e veçanta për dhënien e lejes për të dënuarit që të punojnë jashtë institucionit korrektues dhe procedura për punën e të dënuarve jashtë institucionit korrektues përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Dispozitat e ligjeve të punës, përfshirë dispozitat për të lidhur kontrata të punësimit, kompensimin, dhe festat vlejné ndaj punës së pambikëqyrur të dënuarve jashtë institucioneve korrektuese. Kontrata e punësimit e lidhur me një të dënuar nuk duhet të tregojë se ai ose ajo është duke vuajtur dënimin.

5. Punëdhënësi e bënë bartjen e pagës së të dënuarit, i cili punon jashtë institucionit korrektues, tek llogaria bankare e shërbimit korrektues.

Neni 11

Në nenin 92 të Ligjit fshihen nënparagrafët 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.9.

Neni 12

Neni 94 i Ligjit riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 94

Pezullimi i Përkohshëm i Ekzekutimit të dënimit

1. Pezullimi i përkohshëm i ekzekutimit të ndonjë dënimi nënkupton çdo lirim të personit të dënuar nga objekti korrektues, gjatë të cilit nuk llogaritet koha e vuajtjes së dënimit me burgim.

2. Me kërkesë të personit të dënuar, ose anëtarit të familjes së ngushtë, ose me propozim të drejtorit të institucionit Korrektues dhe me rekomandim të drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues, i cili mbështet, kundërshton apo abstenon nga kërkesa, kryetari i Gjykatës Themelore, kompetente mund të lejojë, pezullim të përkohshëm të një dënimi me burgim, nëse është vërtetuar se

- 2.1. personi i dënuar vuan nga një sëmundje serioze, e cila ia kërcënon jetën;
 - 2.2. trajtimi mjekësor, i cili përndryshe nuk është në dispozicion nën shërbimin korrektues ose institucioneve shëndetësore publike të Kosovës, është në dispozicion të personit të dënuar, nëse lirohet; dhe
 - 2.3. nuk ekziston rrezik serioz i largimit ose përsëritjes së veprës penale e cila nuk mund të lehtësohet me kushtet e atij pezullimi.
3. Aktvendimi për pezullim të përkohshëm të ekzekutimit të dënimit me burgim për arsyet e përmendura në paragrafin 2 duhet të bazohen në vlerësimin mjekësor të një komisioni, i cili përbëhet prej tre (3) mjekëve të emëruar nga kryetari i gjykatës themelore përkatëse. Mjeku që e trajton nuk duhet të jetë pjesë e këtij komisioni, megjithatë raporti i tij/saj mjekësor duhet të merret parasysh nga komisioni.
4. Në rastet kur trajtimi mjekësor mund të bëhet vetëm jashtë vendit, kërkesa për pezullim mund të lejohet vetëm nëse ekziston:
- 4.1. nëse ka një marrëveshje ndërkombëtare ose marrëveshje dypalëshe me këtë vend, sipas kushteve të cilat hetimi mund të kryhen për të verifikuar zbatimin e masës; dhe
 - 4.2. nëse nuk ka pengesë ligjore që personi të arrestohet dhe ekstradohet në rast të heqjes së pezullimit.
5. Para marrjes së aktvendimit, Kryetari i Gjykatës kompetente themelore mund të zhvillojë seanca dëgjimore për të vërtetuar faktet dhe rrethanat që kërkohen në kërkesë.
6. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit nuk duhet të zgjasë më gjatë se sa periudha minimale që është e nevojshme për përfundimin e trajtimit mjekësor.
7. Aktvendimi duhet të përfshijë arsyetimin dhe kohëzgjatjen e pezullimit, detyrimet për raportim dhe të tjera të personit të dënuar si dhe përgjegjësitë për shqyrtimin e rregullt të ekzistimit të bazës që përmenden në paragrafin 2 të këtij neni. Aktvendimi duhet t'i jepet aplikantit dhe prokurorit të shtetit përkatës, e që të dy mund të parashetrojnë ankesë kundër aktvendimit të shkallës së parë në bazë të këtij neni tek kryetari i Gjykatës së Apelit brenda tre (3) ditëve pas pranimit të aktvendimit.
8. Kryetari i Gjykatës së Apelit vendosë për ankesën brenda tre (3) ditëve pas pranimit të saj, përveç nëse ekziston nevojë për mendim shtesë mjekësor të një komisioni të dytë të emëruar në bazë të paragrafit 3. Mjekët që kanë marrë pjesë në komisionin e parë nuk mund të jenë pjesë e komisionit të dytë.
9. Ankesa e ndalon ekzekutimin e aktvendimit.
10. Kohëzgjatja e pezullimit nuk llogaritet si pjesë e kohëzgjatjes së vuajtjes së dënimit.

Neni 13

Neni 97 i Ligjit riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 97

Monitorimi dhe heqja e pezullimit të përkohshëm të ekzekutimit të dënimit

1. Kryetari i gjykatës themelore kompetente do të mbaj seanca të rregullta për të mbikëqyrë dhe verifikuar në çdo kohë, zbatimin e aktvendimit për pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe nëse arsyet për mbështetjen e pezullimit ekzistojnë akoma, përmes policisë drejtpërdrejtë ose përmes shërbimit korrektues. Kryetari mund të emërojë mjekët për të kontrolluar personat e dënuar. Kryetari mund të modifikojë kushtet e vendosura nga personat e dënuar në aktvendimin e pezullimit. Policia, shërbimi korrektues dhe mjekët informojnë kryetarin pa ndonjë vonesë për ndonjë arsye të mundshme të heqjes së pezullimit.
2. Prokurori kompetent i shtetit mund t'i kërkojë kryetarit të gjykatës themelore kompetente të ushtrojë kompetencat në bazë të paragrafit 1 të këtij neni.
3. Sipas detyrës zyrtare, ose me kërkesë të prokurorit kompetent të shtetit, kryetari i gjykatës themelore kompetente e revokon pezullimin e ekzekutimit të dënimit nëse përcaktohet se arsyet që mbështesin këtë pezullim pushojnë së ekzistuari, ose nëse personi i dënuar nuk i zbaton kushtet e aktvendimit për pezullimin e ekzekutimit të dënimit.
4. Personi i dënuar dhe prokurori kompetent i shtetit mund të ushtrojë ankesë kundër aktvendimit të shkallës së parë në bazë të këtij neni tek Kryetari i Gjykatës së Apelit brenda tre (3) ditëve pas pranimit të aktvendimit.
5. Kryetari i Gjykatës së Apelit vendos për ankesën brenda tre (3) ditëve pas pranimit të saj, përveç nëse ekziston nevoja për mendim shtesë shëndetësor të një komisioni të dytë të emëruar në pajtim me paragrafin 3 të nenit 94. Mjekët që kanë marrë pjesë në Komisionin e parë nuk mund të jenë pjesë e komisionit të dytë.
6. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e aktvendimit.
7. Nëse personi i dënuar nuk lajmërohet në shërbimin korrektues pas skadimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit, apo të revokimit të tij, shërbimi korrektues e njofton menjëherë policinë e cila personin e dënuar e sjell për mbajtjen e mëtejshme të dënimit.

Neni 14

Në paragrafin 2 të nenit 110 të Ligjit pas fjalëve “Drejtori i institucionit korrektues” fjala “e ndërpret” zëvendësohet me fjalën “mund të ndërpres”.

Neni 15

Në nenin 111 të Ligjit, paragrafi 2, pas fjalëve “prej së paku”, fjalët “dhjetë (10) metra kub” zëvendësohen me fjalët “tetë (8) metër katror”.

Neni 16

Në nenin 117 të Ligjit, paragrafi 1 pas fjalëve “mjeteve të tilla” shtohet fjalia si në vijim: “lista e mjeteve shtrënguese të lejuara do të përcaktohet me akt nënligjor”.

Neni 17

Në nenin 118 të Ligjit, pas paragrafit 8 shtohet paragrafi i ri 9 me tekstin si në vijim:

9. Pas përdorimit të mjetit shtrëngues të drejtpërdrejtë sa i përket një të dënuari, një profesionist i kujdesit shëndetësor duhet të shqyrtojë gjendjen shëndetësore të dënuarit sa më shpejtë që të jetë e mundur. Rrethanat e përdorimit të mjeteve shtrënguese të drejtpërdrejta dhe rezultatet e kontrollit të shëndetit duhet të regjistrohen.

Neni 18

Neni 122 i Ligjit, paragrafi 2 riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Paneli për lirim me kusht përbëhet prej tre (3) anëtarëve: një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme, i deleguar nga Kryetari i Gjykatës Supreme; një (1) gjyqtar i Gjykatës së Apelit i deleguar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit dhe një (1) gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i deleguar nga Kryetari i Gjykatës Themelore. Në rastet kur me ligj parashihet përjashtimi i anëtarit të panelit në një çështje të caktuar apo zëvendësimi në mungesë të ndonjë anëtari tjetër udhëheqësit e këtyre institucione delegojnë një person tjetër.

Neni 19

Neni 127 i Ligjit riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 127

Lirimi i parakohshëm

1. Me kërkesë të personit të dënuar, Gjykata kompetente mund ta lirojë personin e dënuar para përfundimit të mbajtjes së dënimit të tij me burgim nëse ai ka pasur sjellje të mirë, suksese në punë dhe në aktivitete të tjera.

2. Gjykata kompetente mund të lejojë lirim të parakohshëm në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, nëse personi i dënuar ka mbajtur të paktën tri të katërtat (3/4) e dënimit me burgim dhe nëse të njëjtit i kanë mbetur jo më shumë se tre (3) muaj të dënimit.

3. Në rastet kur paraburgimi vendosen kundër të dënuarit në një rast tjetër, lirimi i parakohshëm mund të jepet vetëm kur paraburgimi në një rast tjetër është zëvendësuar me masë më të butë nga gjykata kompetente.

4. Nëse personit të dënuar i shqiptohet dënimi disiplinor i vetmisë ndërmjet datës së lëshimit të aktvendimit për lirim të parakohshëm dhe datës për lirim të parakohshëm nga mbajtja e dënimit, gjykata kompetente e rishqyrton aktvendimin.

5. Aktvendimi për lirim të parakohshëm sipas këtij neni i dorëzohet personit të dënuar brenda tri (3) ditëve nga dita e marrjes së tij.

Neni 20

Në nenin 201 të Ligjit, paragrafi 1 riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Nëse gjatë kohës së ekzekutimit të masës, i paraburgosuri kryen shkelje disiplinore, apo cilën do kundërvajtje, drejtori i institucionit korrektues e udhëheqë procedurën disiplinore dhe për atë e informon gjykatën.

Neni 21

Në nenin 211 të Ligjit pas fjalës “themelohen” shtohen fjalët “mbyllen apo riklasifikohen”.

Neni 22

Në nenin 219 të Ligjit, paragrafi 2 riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministri përcaktohen gradat e zyrtarëve korrektues, kontrollimi i së kaluarës së tyre, periudha provuese dhe promovimi.

2.1 Me akt nënligjor që e nxjerr Qeveria rregullohen pagat dhe beneficionet e tjera.

Neni 23

Neni 252 i Ligjit fshihet.

Neni 24

1. Kapitulli XIX i Ligjit, fshihet.

2. Shprehja “dënimi me burgim për kundërvajtje”, fshihet nga tërë teksti i Ligjit.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -129
18 prill 2017

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI